




Udhëzues për fëmijët që kërkojnë **azil** në Uells

Guidance for Children seeking **asylum** in Wales



Canolfan
Gyfreithiol
y Plant
Cymru

Children's
Legal
Centre
Wales

Applying to stay in Wales

Wales is part of the UK. Your right to stay in Wales depends on the UK's immigration rules.

You can claim *asylum* in the UK if you've left your own country because you were treated badly for a reason including your race, your religion, your nationality, belonging to a particular social group (such as child soldiers or trafficked children) or holding a political opinion - or you're scared that you will be treated cruelly for one of these reasons.

The law says that asylum claims should be made as soon as possible after someone arrives in the UK.

Asylum: Means a place that is safe. The word is used to describe a process for giving people permission to stay in the UK because they are in danger in the country that they come from.

Aplikimi për të qëndruar në Uells


Uellsi është pjesë e MB. E drejta juaj për të qëndruar në Uells varet nga rregullat e emigracionit në Mbretërinë e Bashkuar.

Ju mund të kërkonit **azil** në MB nëse jeni larguar nga vendi juaj për shkak se jeni trajtuar keq për arsye që përfshijnë racën, fenë, kombësinë, përkatësinë tuaj në një grup të caktuar shoqëror (si fëmijë ushtarë ose fëmijë të trafikuar) ose për shkak se keni dhënë një opinion politik - ose keni frikë se do të trajtoheni mizorisht si pasojë e një prej këtyre arsyeve.

Ligji parashikon se kërkesat për azil duhet të bëhen sa më shpejt që të jetë e mundur pasi personi që aplikon mbërrin në MB.

Azil

Nënkupton një vend që është i sigurt. Fjala përdoret për të përshkruar një proces për dhënien e lejes për të qëndruar në MB, sepse ata janë në rrezik në vendin nga vijnë.



Who can help

A lawyer – They can help you with your asylum claim. They must be regulated by the Law Society or registered with the OISC (Office of the Immigration Services Commissioner) at the right level. Your local authority should make sure you have a lawyer.

Your lawyer should talk to you politely and should give you information about what to do if you are not happy with the service they give you. Complaining about a lawyer will not harm your asylum case and you can find a different lawyer if you need to.

You do not have to pay for a lawyer. It is paid for by the government, like hospitals or schools, but the lawyers do not report to the government.

Local Authority: also known as the council, the organisation that looks after the area of Wales where you live.

A translator or interpreter:

A translator or interpreter - This is so you can understand what's happening and make sure you are understood. They can help in any interviews with the home office and any meetings with your lawyer.

A Social Worker – Someone employed by the local authority to help and support children and adults when they need it. They can help you access services you are entitled to and should act in your 'best interest'.


Best Interest: Please see *Being 'looked after'* on page 16 for more information.

Kush mund t'ju ndihmojë

Avokati – Ata mund t'ju ndihmojnë me kërkesën tuaj për azil. Ato duhet të jenë të rregulluar nga Shoqëria Juridike ose të jenë regjistruar në **OISC** (Zyra e Komisionerit të Shërbimeve të Emigracionit) në nivelin e duhur. **Autoriteti juaj lokal** duhet të sigurohet që të keni një avokat.

Avokati juaj duhet të flasë me ju me mirësjellje dhe duhet t'ju japë informacion se çfarë të bëni nëse nuk jeni të kënaqur me shërbimin që ju japin. Ankesa për një avokat nuk do të dëmtojë çështjen tuaj të azilit dhe ju mund të gjeni një avokat tjetër nëse keni nevojë.

Ju nuk duhet të paguani për një avokat. Ai paguhet nga qeveria, njëlloj si spitalet apo shkollat, por avokatët nuk raportojnë në qeveri.



Autoriteti juaj lokal

I njohur gjithashtu si këshilli, organizata që kujdeset për zonën e Uellsit ku ju jetoni.



Një përkthyes ose interpret - që të kuptoni se çfarë po ndodh dhe të siguroheni që jeni kuptuar. Ata mund të ndihmojnë në çdo intervistë me Home Office dhe në çdo takim me avokatin tuaj.


Punonjësi social – është një person i punësuar nga autoritetet lokale për të ndihmuar dhe mbështetur fëmijët dhe të rriturit kur ata kanë nevojë. Ata mund t'ju ndihmojnë të përdorni shërbimet që ju keni të drejtë dhe duhet të veprojnë në **'interesin tuaj më të mirë'**.

Interesin tuaj më të mirë

Ju lutemi shihni "Të jesh i përkujdesur" në faqen 15 për më shumë informacion.




A Foster Carer – You may live with them and they will look after you on a day-to-day basis by providing food, clothes and emotional support.



Kujdestari birësues – ju mund të jetoni me ta dhe ata do të kujdesen për ju çdo ditë duke ju ofruar ushqim, rroba dhe mbështetje emocionale.

A Nurse or Doctor – These are medical professionals that can support all your health care needs. They will work with your social worker to make sure you are well. Healthcare in Wales is free.

Infermieri ose mjeku – janë profesionistë mjekësorë që mund të mbështesin të gjitha nevojat tuaja të kujdesit shëndetësor. Ata do të punojnë me punonjës të social për t'ju siguruar që jeni mirë. Kujdesi shëndetësor në Uells është falas.




A Teacher – These are the people you will be with every day at school or college and are responsible for your learning.



Mësuesi – janë njerëzit me të cilët do të jeni çdo ditë në shkollë ose kolegji dhe janë përgjegjës për të nxënëit tuaj.

Advocate – is independent and offers support to a child or young person who is looked after including a care leaver. They speak up for you, help ensure your views are listened to and taken seriously by decision makers, your rights are respected and work with you to resolve issues.

Avokati – është i pavarur dhe i ofron mbështetje një fëmije ose të riu për të cilin përkujdeset, duke përfshirë edhe personat që lënë kujdesin. Ata flasin në emrin tuaj, ndihmojnë që pikëpamjet tuaja të dëgjohen dhe të merren seriozisht nga vendimmarrësit, të drejtat tuaja respektohen dhe punojnë me ju për të zgjidhur problemet.




Key Worker – depending on where you live you may have staff at your accommodation to help with your care. One member of staff maybe asked to work closely with you and that person is called your key worker.



Punonjësi kyç – në varësi të vendit ku jetoni, mund të keni staf në banesën tuaj për t'ju ndihmuar me kujdesin tuaj. Një anëtar i stafit mund t'i kërkohet të punojë ngushtë me ju dhe ai person quhet punonjësi juaj kyç.

Young Person's Advisor (YPA) – all those "leaving care" aged 16-18 will be given an advisor, by the LA, who works with you to help you learn the skills you need to live independently.

Këshilltari i të Rinjve (YPA) – të gjithë ata që "lënë kujdesin", të moshës 16-18 vjeç, do t'u caktohet një këshilltar nga LA, i cili punon me ju për t'ju ndihmuar të mësoni aftësitë që ju nevojiten për të jetuar në mënyrë të pavarur.



Welfare (small) interview

You will be invited by the Home Office to attend a welfare (small interview) to check you're ok.

Your social worker or foster carer can help you make an appointment with United Kingdom Visas and Immigration. You will be asked some basic questions, such as your name, your date of birth, your nationality, your ethnicity, your religion, and about your family members. You don't need to go into details about your asylum claim right now. They will also take your photograph and record your fingerprints.

Home Office – a government department that deals with immigration, which includes asylum.

Home Office Caseworkers - are the people who will look into your reasons for wanting asylum and make a decision on whether you can stay.

Statement of Evidence Form

After your short interview you will get a form. This is called a Statement of Evidence Form (SEF). You should get help from a lawyer to fill this in.

The SEF has to be completed in English and be must sent to the Home Office within 60 working days from the date your claim for asylum was made (normally the day of your Welfare Interview but may be longer as it is the date you receive the paperwork). This deadline can be extended.

The SEF asks questions about your family and your journey to the UK. It also asks for a statement. This is a piece of

Proceset e azilit

Intervistë (e shkurtër) rreth mirëqenies

Do të ftoheni nga **Home Office** për të marrë pjesë në një intervistë rreth mirëqenies (intervistë e shkurtër) për të kontrolluar nëse jeni mirë.

Punonjësi juaj social ose kujdestari mund t'ju ndihmojë të caktoni një takim me Zyrën e Vizave dhe të Emigracionit të Mbretërisë së Bashkuar. Do t'ju bëhen disa pyetje themelore, si emri, data e lindjes, kombësia juaj, përkatësia etnike, feja juaj dhe për anëtarët e familjes suaj. Ju nuk keni nevojë të hyni në detaje në lidhje me kërkesën tuaj për azil tani. Ata gjithashtu do t'ju bëjnë fotografi dhe do t'ju marrin gjurmët e gishtërinye tuaj.

Home Office – a government denjë departament qeveritar që merret me emigracionin, i cili përfshin azilin.

Punonjësit e Çështjeve në Home Office - janë njerëzit që do të shqyrtojnë arsyet tuaja për të kërkuar azil dhe do të marrin një vendim nëse mund të qëndroni.



Formulari i Deklaratës së Provës

Pas intervistës suaj të shkurtër, do të merrni një formular. Ky quhet Formulari i Deklaratës së Provës (SEF). Ju duhet të kërkonin ndihmë nga një avokat për ta plotësuar këtë.

SEF duhet të plotësohet në anglisht dhe duhet të dërgohet në Home Office brenda 60 ditëve pune nga data kur është bërë kërkesa juaj për azil (normalisht dita e intervistës suaj të mirëqenies, por mund të jetë më e gjatë pasi kjo është data kur merrni dokumentet). Ky afat mund të zgjatet.

SEF bën pyetje në lidhje me familjen tuaj dhe udhëtimin tuaj në MB. Kërkon gjithashtu një deklaratë. Ky është një tekst që



writing that explains what has happened to you and what you are afraid will happen to you if you had to leave the UK.

If you don't have a lawyer when you get this form, your foster carer, key worker or social worker will help you find one. Your lawyer will ask you if you have any evidence (information/letters) to support what you have said about what you think would happen to you if you are returned to your country. Lots of people do not have any evidence on paper and it will not stop you being allowed to stay in the UK if you do not.

Anything you say is **confidential** – this means your lawyer cannot repeat anything you tell them without your consent (if you do not want them to). The only times they can tell someone else what you have said is if they think that you are going to harm yourself, someone else, or if you are threatening terrorism. You can have someone to support you in meetings with your lawyer if you want, but you do not have to. You should be asked if you are happy with who is in the room with you.

If it is difficult to speak about what has happened there are lots of things that can be done to help.

- ▶ If possible, find an adult you trust to help write it down for you and ask you questions if some things are not clear.
- ▶ You may also find it easier to draw pictures or find pictures on the internet to help explain what you want to say.
- ▶ You could try recording yourself speaking
- ▶ In your appointments with your lawyer, ask for an interpreter if you need one. Even if your English is good it is often harder to talk about difficult things in a different language. If you are not comfortable with the interpreter, it is important that you tell someone.
- ▶ Make sure you ask your lawyer to give you time to explain yourself and if you don't understand what they say, ask them to repeat or to explain it another way.

Sometimes if a person has been hurt badly they will need to go and see a doctor, to check that they are OK, both physically and mentally. This can help explain what has happened to them to the Home Office so that they don't have to. It is not a bad thing if you have to see a doctor about your mental health, it is important for you to be fit and healthy.

shpjegon se çfarë ju ka ndodhur dhe çfarë keni frikë se do t'ju ndodhë nëse do t'ju duhet të largoheni nga MB.

Nëse nuk keni një avokat të caktuar kur merrni këtë formular, kujdestari juaj birësues, punonjësi kyç ose punonjësi social do t'ju ndihmojë të gjeni një të tillë. Avokati juaj do t'ju pyesë nëse keni ndonjë provë (informacion/letra) për të mbështetur atë që keni thënë lidhur me çfarë mendoni se do t'ju ndodhte nëse ktheheni në vendin tuaj. Shumë njerëz nuk kanë asnjë provë shkresore dhe kjo nuk do t'ju pengojë të qëndroni në MB nëse nuk e keni.

Çdo gjë që ju thoni është **konfidenciale** – kjo do të thotë se avokati juaj nuk mund të përsërisë asgjë që ju i thoni pa pëlqimin tuaj (nëse ju nuk e dëshironi). Ata mund t'i tregojnë dikujt tjetër atë që keni thënë vetëm nëse ata mendojnë se ju do të dëmtoni veten, dikë tjetër ose nëse po kërcënoni me terrorizëm. Nëse dëshironi, mund të keni dikë që t'ju mbështesë në takimet me avokatin tuaj, por nuk ju nevojitet. Ju duhet të pyeteni nëse jeni të kënaqur me atë që është në dhomë me ju.

Nëse e keni të vështirë të flisni për atë që ka ndodhur, ka shumë gjëra që mund të bëhen për t'ju ndihmuar.

- ▶ Nëse është e mundur, gjeni një të rritur të cilit i besoni për t'ju ndihmuar ta shkruajë atë në emrin tuaj dhe t'ju bëjë pyetje nëse ka gjëra të paqarta.
- ▶ Ju gjithashtu mund ta keni më të lehtë të vizatoni ose të gjeni fotografi në internet që ju ndihmojnë të shpjegoni atë që dëshironi të thoni.
- ▶ Mund të provoni të regjistroni veten duke folur.
- ▶ Në takimet tuaja me avokatin tuaj, kërkoni një interpret nëse ju nevojitet. Edhe nëse anglishtja juaj është e mirë, shpesh është më e vështirë të flisni për gjëra të vështira në një gjuhë tjetër. Nëse nuk jeni të kënaqur me interpretin, është e rëndësishme t'i tregoni dikujt.
- ▶ Sigurohuni që t'i kërkoni avokatit tuaj t'ju japë kohë për t'u shpjeguar dhe nëse nuk kuptoni se çfarë thonë ata, kërkoni që ta përsërisin ose ta shpjegojnë në një mënyrë tjetër.

onjëherë nëse një person është lënduar keq, ai do të duhet të vizitohet tek një mjek, për të kontrolluar nëse është mirë, si fizikisht edhe mendërisht. Kjo mund të ndihmojë



në shpjegimin e asaj që u ka ndodhur atyre në Home Office, në mënyrë që ata të mos kenë nevojë. Nuk është gjë e keqe nëse duhet të vizitoheni tek mjeku për shëndetin tuaj mendor, pasi është e rëndësishme që të jeni në formë dhe të shëndetshëm.

Substantive (big) interview

Intervistë (e gjatë) thelbësore



If you are over 12 years old, you will normally have a big interview where the Home Office caseworker will ask you questions about why you came to the UK, your journey, your life before the UK. If your lawyer does not think you are fit enough, physically, mentally or emotionally to be interviewed then they can write to the Home Office and ask them to decide your case in another way.

The interview is where the Home Office tries to find out more about what scared you so much that you had to leave your own country, or what your family said might happen to you if you stayed. They will already have the information in your SEF form and statement. They should not ask you questions about what you have already told them unless they don't understand something. If you came to the UK without a passport or other documents to show what country you are from, they might ask you some questions about your home country (for example important places, the money that is used or sports teams). They might also ask you to speak to someone on the telephone so they can learn more about where you are from the way you speak; this is called a 'language assessment'.

Nëse jeni mbi 12 vjeç, normalisht do të bëni një intervistë të madhe, ku punonjësi i çështjes në Home Office do t'ju bëjë pyetje lidhur me arsyet përse keni ardhur në MB, udhëtimin tuaj, jetën tuaj përpara se të mbërrinit në MB. Nëse avokati juaj mendon se nuk jeni mjaftueshëm të aftë fizikisht, mendërisht ose emocionalisht për t'u intervistuar, atëherë ai mund t'i shkruajë Home Office dhe t'i kërkojë të vendosë për çështjen tuaj në një mënyrë tjetër.

Në intervistë, Home Office përpiqet të mësojë më shumë rreth asaj që ju frikësoi aq shumë sa ju desh të lini vendin tuaj, ose çfarë tha familja juaj se mund t'ju ndodhte po të qëndronit. Ata do të kenë përpara informacionin në formularin dhe deklaratën tuaj SEF. Ata nuk duhet t'ju bëjnë pyetje në lidhje me atë që ju e keni thënë tashmë, vetëm nëse nuk kuptojnë diçka. Nëse keni ardhur në MB pa pasaportë ose dokumente të tjera, për të treguar se nga cili vend jeni, ata mund t'ju bëjnë disa pyetje në lidhje me vendin tuaj të origjinës (për shembull vende me rëndësi, paratë që përdoren ose ekipet sportive). Ata gjithashtu mund t'ju kërkojnë të flisni me dikë në telefon, në mënyrë që ata të mësojnë më shumë se nga vini prej mënyrës se si flisni; ky quhet "vlerësim gjuhësor".



Who's in the Interview and why?

- ▶ Your social worker (or a responsible adult) – are there to make sure that you are staying well, and to ask for breaks if you need them;
- ▶ Your lawyer - are there to observe and take notes, they cannot answer questions for you;
- ▶ An interpreter from the Home Office -If you would find it easier to have a man or a woman interpreter you can ask for that. You cannot ask for the interpreter to be from a specific country.

It can be a long and tiring interview, but you can ask for breaks if you are tired or upset. Your social worker or responsible adult can ask for these breaks for you.

Kush merr pjesë në intervistë dhe pse?

- ▶ Punonjësi juaj social (ose një i rritur përgjegjës) – janë aty për t'ju siguruar që po qëndroni mirë dhe për të kërkuar pushime nëse keni nevojë për to;
- ▶ Avokati juaj – është aty për të vëzhguar dhe mbajtur shënime, por nuk mund t'i përgjigjet pyetjeve;
- ▶ Interpret nga Home Office - Nëse do ta kishit më të lehtë sikur të kishit një interpret ose interprete, kërkojeni këtë. Ju nuk mund të kërkonit që interpreti të jetë nga një vend i caktuar.

Intervista mund të zgjasë dhe të jetë e lodhshme, por mund të kërkonit pushime nëse ndiheni të lodhur ose të mërzitur. Punonjësi juaj social ose i rrituri përgjegjës mund t'i kërkojë këto pushime në emrin tuaj.



After your Asylum interview

You should have a meeting with your lawyer after your asylum interview to check that you are ok with how it went. They should read the written record of your asylum interview back to you, to make sure that it was all written down correctly. They will be able to write to the Home Office if there is anything you need to add or change.

When you've made your claim

The Home Office can take many months to make a decision on your asylum claim. If you are worried you've been waiting too long for a decision, you can ask your lawyer to contact the Home Office.

The first thing the Home Office will decide is whether your claim can be processed in the UK, you should not be told that your claim cannot be decided in the UK because you have travelled through another country, but the Home Office will consider whether there are any family members in another country that could look after you. You will only be sent to live with them if both you and they agree and the Local Authority consider that it is in your best interests to live with them.

When the Home Office has made a decision, they must tell your social worker and lawyer what they have decided. Every case is different, but there are a number of different outcomes. If you are granted refugee status then how long you can stay in the UK will depend on how you travelled to the UK:

- ▶ If you came directly to the UK from your home country you will be granted permission to stay in the UK for 5 years and you will be able to apply for indefinite leave to remain at the end of that time (this is called being a 'Group 1' refugee)
- ▶ If you travelled through other countries where the Home Office does not accept that you were in danger then you would be considered a 'Group 2' refugee. You will be granted permission

Pas intervistës tuaj për azil

Ju duhet të mbani një takim me avokatin tuaj pas intervistës tuaj për azil për të kontrolluar nëse jeni mirë me mënyrën se si shkoi. Ata duhet t'ju lexojnë të dhënat me shkrim të intervistës tuaj për azil, për t'u siguruar që të gjitha janë shkruar saktë. Ata do të jenë në gjendje t'i shkruajnë Home Office nëse ka diçka që ju duhet të shtoni ose ndryshoni.

Pasi të keni bërë kërkesën tuaj

Home Office mund t'i duhet shumë muaj për të marrë një vendim për kërkesën tuaj për azil. Nëse jeni të shqetësuar se keni pritur shumë gjatë për një vendim, mund t'i kërkonti avokatit tuaj të kontaktojë Home Office.

Home Office do të vendosë së pari nëse kërkesa juaj mund të përpunohet në MB. Nuk duhet t'ju thuhet se nuk mund të merret vendim për kërkesën tuaj në MB për shkak se keni kaluar nëpër një vend tjetër, por Home Office do të shqyrtojë nëse ka ndonjë anëtar të familjes në një vend tjetër që mund të kujdeset për ju. Ju do të dërgoheni për të jetuar me ta vetëm nëse ju dhe ata bini dakord dhe Autoriteti Vendor vlerëson se është në interesin tuaj më të mirë të jetoni me ta.

Kur Home Office ka marrë një vendim, ata duhet t'i tregojnë punonjësit tuaj social dhe avokatit se çfarë kanë vendosur. Çdo rast është i ndryshëm, por ka një sërë rezultatesh të ndryshme. Nëse ju jepet statusi i refugjatit, atëherë kohëzgjatja e qëndrimit tuaj në MB do të varet nga mënyra se si keni udhëtuar për në MB:

- ▶ Nëse keni ardhur direkt në MB nga vendi juaj i origjinës, do t'ju jepet leja për të qëndruar në MB për 5 vjet dhe do të keni mundësi të aplikoni për leje qëndrimi pa afat në fund të asaj kohe (kjo quhet refugjat i "Grupit 1")
- ▶ Nëse keni udhëtuar nëpër vende të tjera ku Home Office nuk pranon se keni qenë në rrezik, atëherë do të konsideroheni si refugjat i "Grupit 2". Do t'ju jepet leje për



to stay 30 months (2 and a half years) and you can apply to have this extended before it finishes. You will need to take specialist advice as to whether you apply for indefinite leave to remain after 5 or 10 years.

If you are fleeing a dangerous situation rather than persecution specific to you, you may be given 'humanitarian protection'. The rules for this type of protection are the same as for 'Group 2' refugees and you will be given permission to stay in blocks of 30 months. In some circumstances, if you came to the UK from somewhere else in the EU under s.67 of the Immigration Act and you are not granted asylum, you may get **s.67 leave** which means you will be able to stay in the UK for 5 years, receive financial support from the UK Government and access public services during that time. After 5 years you will be able to apply for 'Indefinite Leave to Remain' in the UK but there is no guarantee you will receive this.

Your case may be different to the above, and your lawyer will be able to explain more. If you aren't given asylum or humanitarian protection, and are not entitled to s.67 leave, you cannot be removed from the UK until you are 18 years old. If you are under 17 and a half years old when you are refused you will be given permission to stay either for 30 months or until you are 17 and a half years old. You can apply to extend this, if you'd like to stay longer in the UK.

If you don't agree with the decision that is made about your application, you can usually appeal. Your lawyer will talk to you about whether they can represent you for free in your appeal. Sometimes lawyers cannot do appeals for free because the chances of winning are not high enough.

Age assessment

If the Home Office thinks you look older (or younger) than the age you say you are, you may have to have an age assessment. This will be completed by social workers and should be done within 28 days.

You will be asked lots of questions across some different meetings – some may be quite personal and will cover lots of things to try and establish your age. You'll be asked if you have any documents with you that confirm who you are and your age.

të qëndruar për 30 muaj (2 vjet e gjysmë) dhe mund të aplikoni për ta zgjatur këtë para skadimit të periudhës së qëndrimit. Do t'ju duhet të merrni këshilla të specializuara nëse aplikoni për leje qëndrimi pa afat pas 5 ose 10 vjetësh.

Nëse po ikni nga një situatë e rrezikshme dhe jo nga një persekutim posaçërisht ndaj jush, mund t'ju jepet "mbrojtje humanitare". Rregullat për këtë lloj mbrojtjeje janë të njëjta si për refugjatët e "Grupit 2" dhe do t'ju jepet leje për të qëndruar në periudha prej 30 muajsh. Në disa rrethana, nëse keni ardhur në MB nga një vend tjetër i BE sipas s.67 të Aktit të Emigracionit dhe nuk ju jepet azili, mund të merrni **leje sipas s.67** që do të thotë se do të jeni në gjendje të qëndroni në MB për 5 vjet, të merrni mbështetje financiare nga Qeveria e Mbretërisë së Bashkuar dhe të aksesoni shërbimet publike gjatë kësaj kohe. Pas 5 vjetësh, do të mund të aplikoni për "Leje qëndrimi pa afat" në MB, por nuk ka asnjë garanci që do ta merrni këtë leje.

Rasti juaj mund të jetë i ndryshëm nga sa më sipër, dhe avokati juaj do të jetë në gjendje të shpjegojë më shumë lidhur me këtë. Nëse nuk ju jepet azil apo mbrojtje humanitare dhe nuk keni të drejtë për leje sipas s.67, nuk mund të largoheni nga MB deri sa të mbushni 18 vjeç. Nëse jeni nën 17 vjeç e gjysmë kur ju refuzohet leja, do t'ju jepet leja për të qëndruar ose për 30 muaj ose deri në moshën 17 vjeç e gjysmë. Ju mund të aplikoni për të zgjatur këtë periudhë qëndrimi, nëse dëshironi të qëndroni më gjatë në MB.

Nëse nuk jeni dakord me vendimin që është marrë për aplikimin tuaj, zakonisht ju mund ta apeloni atë. Avokati juaj do t'ju shpjegojë nëse ai mund t'ju përfaqësojnë falas në apelimin tuaj. Ndonjëherë avokatët nuk mund të bëjnë apeline falas sepse shanset për të fituar nuk janë shumë të larta.

Vlerësimi i moshës

Nëse Home Office mendon se dukeni më i/e madh/e në moshë (ose më i/e ri/e) se mosha që keni raportuar, mund të lindë nevoja për një vlerësim të moshës. Kjo do të kryhet nga punonjësit socialë dhe duhet të bëhet brenda 28 ditëve.

Do t'ju bëhen shumë pyetje gjatë disa takimeve të ndryshme – disa mund të jenë mjaft personale dhe do të mbulojnë shumë gjëra për të provuar dhe vendosur mbi moshën tuaj. Do të pyeteni nëse keni ndonjë dokument me vete që konfirmon se kush jeni dhe moshën tuaj.



During these meetings, an Appropriate Adult can be there to make sure everything is okay during the assessment and to look out for you.

You should be treated as a child until the decision is made about your age. If the decision is that you are under 18, you will continue to be treated as a child. If the decision is that you are 18 or older, you will be treated as an adult and a different asylum system applies. If this happens, you can ask for help to have your age recognised and be treated as a child. You can talk to a lawyer for advice and representation.

The outcome of the age assessment must be communicated to you in a way you understand, and you have 3 months to challenge this outcome.

A decision about your asylum claim should not be made until everyone has agreed on how old you are. If the decision is taken that you are over 18, the Home Office may decide that your asylum claim should not be processed in the UK and you may be taken to another country (Rwanda, which is in Africa) for your claim to be processed. If you are granted asylum there you will be granted permission to stay in Rwanda, but will not be brought back to the UK.

It is very important that you get specialist legal advice as quickly as possible if an age assessment states an age that is different to the one you have given.

Your **Appropriate Adult** should support, advise and assist and can be your social worker, key worker or another adult that can support you.

Gjatë këtyre takimeve, një **i rritur i përshtatshëm** mund të jetë i pranishëm për t'u siguruar që gjithçka është në rregull gjatë vlerësimit të moshës dhe për t'u kujdesur për ju.

Ju duhet të trajtoheni si fëmijë derisa të merret vendimi për moshën tuaj. Nëse vendimi thotë se jeni nën 18 vjeç, do të vijoni të trajtoheni si fëmijë. Nëse vendimi thotë që jeni 18 vjeç ose më i/e madh/e, do të trajtoheni si i/e rritur dhe do të zbatohet një sistem tjetër azili. Nëse kjo ndodh, ju mund të kërkonit ndihmë për të njohur moshën tuaj dhe për t'u trajtuar si fëmijë. Ju mund të flisni me një avokat për këshilla dhe përfaqësim.

Rezultati i vlerësimit të moshës duhet t'ju komunikohet në një mënyrë që ju e kuptoni dhe keni 3 muaj kohë për ta kundërshtuar këtë rezultat.

Nuk duhet të merret vendim për kërkesën tuaj për azil derisa të gjithë të kenë rënë dakord se sa vjeç jeni. Nëse vendoset se jeni mbi 18 vjeç, Home Office mund të vendosë që kërkesa juaj për azil të mos shqyrtohet në MB dhe ju mund të dërgoheni në një vend tjetër (Ruanda, e cila është në Afrikë) për përpunimin e kërkesës suaj. Nëse ju jepet azili atje, do t'ju jepet leja për të qëndruar në Ruandë, por nuk do të ktheheni në MB.

Është shumë e rëndësishme që të merrni këshilla ligjore të specializuara sa më shpejt që të jetë e mundur nëse vlerësimi i moshës tregon një moshë që është e ndryshme nga ajo që keni deklaruar.

I rrituri i përshtatshëm i caktuar për ju duhet t'ju japë mbështetje, këshilla dhe ndihmë dhe mund të jetë punonjësi juaj social, punonjësi kyç ose një i rritur tjetër që mund t'ju mbështesë.



My Rights

If you are under 18, you are treated 'as a child', and in accordance with the United Nations Convention on the Rights of the Child (UNCRC) this means:

- ▶ Decisions taken by adults about you should always be in your 'best interests'. However, the decision about whether you are allowed to stay in the UK can take into consideration other things.
- ▶ Your views should be listened to and taken into account when decisions are made
- ▶ Your language, culture and religion should be respected
- ▶ You should be kept safe from harm
- ▶ You shouldn't be detained

A decision that is in your 'best interests' is a decision taken by adults which takes into account all the relevant circumstances, including your views. It may not always be the decision you want. If you disagree with a decision that has been made about you, there are lawyers that can help advise you on whether you can challenge the decision. Your immigration lawyer might be able to help you to contact one of those lawyers.

If I can't stay in the UK

The process of applying for asylum can take a long time and it might be decided that you cannot stay in the UK. The UK Government has to consider its own rules about returning people to countries that it judges to be unsafe. Your lawyer will advise you. If you do have to return home, travel arrangements will be made by the UK Government. This might not happen straight away, and can be a very long time after you are refused asylum.

At any time after you are 18 the Home Office can 'detain' you. This should only happen if they are going to remove you from the UK quickly after they detain you.

Detain - This means to keep you in a centre where you cannot leave.



Të drejtat e mia

Nëse jeni nën 18 vjeç, ju trajtoheni 'si fëmijë' dhe në përputhje me Konventën e Kombeve të Bashkuara për të Drejtat e Fëmijës (UNCRC) kjo do të thotë që:

- ▶ Vendimet e marra nga të rriturit për ju duhet të jenë gjithmonë në 'interesin tuaj më të mirë'. Megjithatë, vendimi nëse ju lejohet të qëndroni në MB mund të marrë parasysh edhe gjëra të tjera.
- ▶ Pikëpamjet tuaja duhet të dëgjohen dhe të merren parasysh kur merren vendime
- ▶ Gjuha, kultura dhe feja juaj duhet të respektohen
- ▶ Ju duhet të mbaheni të sigurt nga dëmtimi
- ▶ Ju nuk duhet të ndaloheni nga autoritetet

Një vendim që është në 'interesin tuaj më të mirë' është një vendim i marrë nga të rriturit, i cili merr parasysh të gjitha rrethanat përkatëse, duke përfshirë pikëpamjet tuaja. Mund të mos jetë gjithmonë vendimi që dëshironi. Nëse nuk jeni dakord me një vendim që është marrë për ju, ka avokatë që mund t'ju ndihmojnë me këshilla nëse mund ta kundërshtoni vendimin. Avokati juaj i emigracionit mund të jetë në gjendje t'ju ndihmojë të kontaktoni një nga ata avokatë.



Nëse nuk mund të qëndroj në MB

Procesi i aplikimit për azil mund të zgjasë shumë dhe mund të vendoset që ju nuk mund të qëndroni në MB. Qeveria e Mbretërisë së Bashkuar duhet të marrë parasysh rregullat e veta për kthimin e njerëzve në vendet që ajo i gjykon si të pasigurta. Avokati juaj do t'ju këshillojë. Nëse ju duhet të ktheheni në shtëpi, rregullimet e udhëtimit do të bëhen nga Qeveria e Mbretërisë së Bashkuar. Kjo mund të mos ndodhë menjëherë dhe mund të ndodhë shumë kohë pasi t'ju refuzohet azili.

Në çdo kohë pasi të mbushni 18 vjeç, Home Office mund t'ju '**ndalojë**'. Kjo duhet të ndodhë vetëm nëse ata do t'ju largojnë nga MB menjëherë pas ndalimit.

Ndalohë

Kjo nënkupton mbajtjen në një qendër ku nuk mund të largoheni.

Applying to stay for longer

If you want to apply for 'Indefinite Leave to Remain' in the UK, or want to extend your leave to remain in the UK, you must make your application before your existing leave runs out.

My Family

If you have been granted refugee status and can stay in the UK, there are limited situations where you can apply for parents and siblings to join you, but it is very unlikely that they will be able to. Your lawyer will advise you. If you've come to Wales but your parents are in another EU country, the authorities may decide that it is in your 'best interests' to be reunited with your family in that other country.

If you have come to the UK to join family members here, you will still need to sort out your immigration status. Your lawyer will advise you.

Aplikimi për qëndrim më të gjatë

Nëse dëshironi të aplikoni për "Leje qëndrimi pa afat" në MB, ose dëshironi të zgjasni lejen tuaj për të qëndruar në MB, duhet ta bëni kërkesën tuaj përpara se të mbarojë leja juaj ekzistuese e qëndrimit.

Familja ime

Nëse ju është dhënë statusi i refugjatit dhe mund të qëndroni në MB, ka situata të kufizuara ku mund të aplikoni që prindërit dhe vëllezërit e motrat t'ju bashkohen, por ka shumë pak gjasa që ata të jenë në gjendje t'ju bashkohen. Avokati juaj do t'ju këshillojë. Nëse keni mbërritur në Uells, por prindërit tuaj janë në një vend tjetër të BE-së, autoritetet mund të vendosin që është në 'interesin tuaj më të mirë' të ribashkoheni me familjen tuaj në atë vend tjetër.

Nëse keni ardhur në MB për t'u bashkuar me anëtarët e familjes këtu, do t'ju duhet ende të zgjidhni statusin tuaj të emigracionit. Avokati juaj do t'ju këshillojë.



Your rights when you are in Wales

Wales recognises the United Nations Convention on the Rights of the Child (UNCRC) which means that while you're in Wales, you should be able to enjoy life 'as a child'.

While you are in Wales, you have rights, including:

- ▶ The right to medical care
- ▶ The right to education
- ▶ The right to somewhere safe to live
- ▶ The right to be protected from abuse and neglect
- ▶ The right to play and relax
- ▶ The right to your religion and culture

You're not expected to manage on your own – there's help and support here for you.

Të drejtat tuaja kur jeni në Uells

Uellsi njeh Konventën e Kombeve të Bashkuara për të Drejtat e Fëmijëve (UNCRC) që do të thotë se gjatë kohës që jeni në Uells, duhet të jeni në gjendje të shijoni jetën 'si fëmijë'.

Gjatë kohës që jeni në Uells, ju keni të drejta, duke përfshirë:

- ▶ E drejta për kujdes mjekësor
- ▶ E drejta për arsimim
- ▶ E drejta për një vend të sigurt për të jetuar
- ▶ E drejta për t'u mbrojtur nga abuzimi dhe neglizhenca
- ▶ E drejta për të luajtur dhe për t'u çlodhur
- ▶ E drejta për fenë dhe kulturën tuaj

Nuk pritet që t'ia dilni vetë – këtu ka ndihmë dhe mbështetje për ju.

Medical care in Wales

You are entitled to free healthcare from the National Health Service (NHS) in Wales. You can:

- ▶ See a doctor at a local surgery, or have dental treatment
- ▶ Go to hospital in an emergency (including a dental hospital)
- ▶ Get any medicines a doctor thinks you need

Kujdesi mjekësor në Uells

Ju keni të drejtë për kujdes shëndetësor falas nga Shërbimi Shëndetësor Kombëtar (NHS) në Uells. Ju mund të:

- ▶ Vizitoheni tek një mjek në një qendër lokale ose të bëni trajtim dentar
- ▶ Shkoni në spital në rast urgjence (përfshirë një spital dentar)
- ▶ Merrni çdo ilaç që mjeku mendon se ju nevojitet



Education in Wales

- ▶ If you want to continue your education, you will be able to do this.
- ▶ You're entitled to free education in Wales until you're 18.
- ▶ You have to go to school, or be in some other kind of education, until you are 16.
- ▶ You will be supported to learn English and Welsh while you're at school in Wales.

Finding somewhere to live

If you're under 18, you will be provided with somewhere to live by the local authority. This could be:

- ▶ In 'foster care' – where you'll live in a 'family' environment, maybe with other children
- ▶ In a 'children's home' – where you will live with a small number of other looked after children
- ▶ In a flat or other accommodation that is suitable for you if you need more independence. You may live with other young people like yourself.

If you have accommodation from the local authority, you are 'looked after' by them.

Arsimi në Uells

- ▶ Nëse dëshironi të vazhdoni arsimin tuaj, do të jeni në gjendje ta bëni këtë.
- ▶ Ju keni të drejtë për arsimim falas në Uells deri në moshën 18 vjeç.
- ▶ Ju duhet të shkoni në shkollë, ose të ndiqni ndonjë lloj tjetër edukimi, deri në moshën 16 vjeç.
- ▶ Ju do të merrni mbështetje për të mësuar anglisht dhe uellsisht gjatë kohës ë jeni në shkollë në Uells.

Gjetja e një vendi për të jetuar

Nëse jeni nën 18 vjeç, autoriteti lokal do t'ju ofrojë një vend për të jetuar. Kjo mund të jetë:

- ▶ Në 'kujdestarinë' – ku do të jetoni në një mjedis 'familjar', ndoshta me fëmijë të tjerë
- ▶ Në një 'shtëpi për fëmijë' – ku do të jetoni me një numër të vogël fëmijësh të tjerë të përkujdesur
- ▶ Në një banesë ose strehim tjetër që është i përshtatshëm për ju nëse keni nevojë për më shumë pavarësi. Ju mund të jetoni me të rinj të tjerë si ju.

Nëse përfitoni akomodim nga autoritetet lokale, ju jeni nën 'përkujdesjen' e tyre.



Being 'Looked After'

In Wales, we believe that every child needs the support of adults to help them grow and develop. If you're not with your parents, the *local authority* will provide support for you through a *social worker*. This is known as being 'looked after'.

Your social worker can't make decisions about whether you can stay in the UK, but they can help you with things like getting medical treatment, organising education or training, or with finding community support for you while you're living in Wales.

The local authority must:

- ▶ Provide food to eat;
- ▶ Provide clothes to wear;
- ▶ Find out what other things you need for your health, education, and care.

If you are under 18, there are some decisions that should be made by whoever has parental responsibility for you. But you should be involved in all decisions about you.

You will be looked after until you are 18. If you are allowed to stay in the UK and have been 'looked after' for 13 weeks or more, you can get ongoing support beyond the age of 18.

You will be supported by adults' whichever type of accommodation is arranged for you. You could live in a 'family' environment with a foster carer, or in a children's home with other young people. If you are 16 or 17, you might be given somewhere to live that is more independent. Wherever you live, it must be safe for you. You will be expected to respect and follow the rules where you are living to keep everyone safe.

Local authority

also known as the council, the organisation that looks after the area of Wales where you live.

Social worker

someone employed by the local authority to help and support children and adults when they need it

Të jesh 'i përkujdesur'



Në Uells, ne besojmë se çdo fëmijë ka nevojë për mbështetjen e të rriturve për t'i ndihmuar ata të rriten dhe të zhvillohen. Nëse nuk jeni me prindërit tuaj, **autoritetet lokale** do t'ju ofrojnë mbështetje nëpërmjet një **punonjësi social**. Kjo njihet si "përkujdesje".

Punonjësi juaj social nuk mund të marrë vendime nëse mund të qëndroni në MB, por ai mund t'ju ndihmojë me gjëra të tilla si marrja e trajtimit mjekësor, organizimi i arsimit ose trajnimit, ose gjetja e mbështetjes nga komuniteti për ju gjatë kohës që jetoni në Uells.

Autoriteti vendor duhet t'ju:

- ▶ Sigurojë ushqim për të ngrënë;
- ▶ Sigurojë rroba për të veshur;
- ▶ Kuptojë se cilat gjëra të tjera ju nevojiten për shëndetin, edukimin dhe kujdesin tuaj.

Nëse jeni nën 18 vjeç, ka disa vendime që duhet të merren nga kushdo që ka përgjegjësinë prindërore për ju. Por ju duhet të përfshihen në të gjitha vendimet që merren për ju.

Do të kujdeseni deri në moshën 18 vjeç. Nëse ju lejohet të qëndroni në MB dhe keni qenë "përkujdesur" për 13 javë ose më shumë, mund të merrni mbështetje të vazhdueshme përtej moshës 18 vjeç.

Ju do të merrni mbështetje me çfarëdo lloj akomodimi që është caktuar për ju nga të rriturit. Ju mund të jetoni në një mjedis "familjar" me një kujdestar, ose në një shtëpi fëmijësh me të rinj të tjerë. Nëse jeni 16 ose 17 vjeç, mund t'ju caktohet një vend për të jetuar që është më i pavarur. Kudo që të jetoni, duhet të jetë e sigurt për ju. Nga ju pritët të respektoni dhe ndiqni rregullat ku po jetoni për të qenë të gjithë të sigurt.

Autoritetet lokale

i njohur gjithashtu si këshilli, organizata që kujdeset për zonën e Uellsit ku ju jetoni.

Punonjësi social

dikush i punësuar nga autoritetet lokale për të ndihmuar dhe mbështetur fëmijët dhe të rriturit kur ata kanë nevojë

Your Care Plan

The services that the local authority will organise for you will be included in a Care Plan. This document will include:

- ▶ The support you need to make your asylum claim or deal with other immigration issues
- ▶ Details about your education and how you would like to progress and develop
- ▶ Any health problems that need to involve a doctor or dentist or other health professional
- ▶ Any needs you have in relation to your identity and culture
- ▶ What the outcomes should be for you
- ▶ Help you may need to develop independent living skills in preparation for becoming an adult
- ▶ Who is responsible for making sure your needs are met, and helping you to achieve your outcomes.

Plani juaj i kujdesit

Shërbimet që autoriteti vendor do të organizojë për ju do të përfshihen në një Plan Kujdesi. Ky dokument do të përfshijë:

- ▶ Mbështetjen që ju nevojitet për të bërë kërkesën tuaj për azil ose për t'u marrë me çështje të tjera të emigracionit
- ▶ Detaje rreth arsimimit tuaj dhe mënyrën se si dëshironi të përparoni dhe zhvilloheni
- ▶ Çdo problem shëndetësor që duhet të përfshijë një mjek ose dentist ose profesionist tjetër shëndetësor
- ▶ Çdo nevojë që keni në lidhje me identitetin dhe kulturën tuaj
- ▶ Cilat duhet të jenë rezultatet për ju
- ▶ Ju mund t'ju nevojitet ndihmë për të zhvilluar aftësitë e të jetuarit të pavarur në përgatitje për t'u bërë i rritur
- ▶ Kush është përgjegjës që të sigurojë që nevojat tuaja të plotësohen dhe t'ju ndihmojë të arrini rezultatet tuaja.



My rights when I'm being 'looked after'

All children in Wales have rights under the United Nations Convention on the Rights of the Child (UNCRC). These rights apply to you if you're being 'looked after'. These include;

- ▶ Decisions taken by adults about you should be made in your 'best interests'
- ▶ Your views should be listened to and taken into account when decisions are made
- ▶ Your language, culture and religion should be respected
- ▶ You should be kept safe from harm

Best interests

A decision taken by adults which takes into account all the relevant circumstances, including your views. It may not always be the decision you want.

Thinking about life as an adult

If you've been looked after for 13 weeks before you are 18, the local authority can continue to support you as you become an adult, if you would like this. Your social worker will work with you to prepare a Pathway Plan, and will explain to you what this Plan is and how it will help you.

When you turn 18 (or slightly earlier at 16 sometimes), another important person will replace your social worker and help you out – a Young Person Advisor. They will write everything they plan to do to help you in a Pathway Plan, after agreeing it with you.

If you aren't entitled to support once you are 18, or you don't want it, you may still be able to get some assistance, but this will depend on your right to stay in the UK.



Të drejtat e mia kur jam duke u 'përkujdesur'

Të gjithë fëmijët në Uells kanë të drejta sipas Konventës së Kombeve të Bashkuara për të Drejtat e Fëmijëve (UNCRC). Këto të drejta zbatohen për ju nëse jeni duke marrë 'përkujdesje'. Këto përfshijnë:

- ▶ Vendimet e marra nga të rriturit për ju duhet të merren në '*interesin tuaj më të mirë*'
- ▶ Pikëpamjet tuaja duhet të dëgjohen dhe të merren parasysh kur merren vendime
- ▶ Gjuha, kultura dhe feja juaj duhet të respektohen
- ▶ Ju duhet të mbaheni të sigurt nga dëmtimi

Interesin tuaj më të mirë

Një vendim i marrë nga të rriturit, i cili merr parasysh të gjitha rrethanat përkatëse, duke përfshirë pikëpamjet tuaja. Mund të mos jetë gjithmonë vendimi që dëshironi.

Të menduarit e jetës si i rritur

Nëse keni marrë përkujdesje për 13 javë përpara se të mbushni 18 vjeç, autoriteti lokal mund të vazhdojë t'ju mbështesë kur të bëheni të rritur, nëse e dëshironi këtë. Punonjësi juaj social do të punojë me ju për të përgatitur një **Plan Rrugëtimi** dhe do t'ju shpjegojë se çfarë është ky Plan dhe si do t'ju ndihmojë.

Kur të mbushni 18 vjeç (ose pak më herët që 16 vjeç ndonjëherë), një person tjetër me rëndësi do të zëvendësojë punonjësin tuaj social dhe do t'ju ndihmojë - një këshilltar për të rinj. Ata do të shkruajnë gjithçka që planifikojnë të bëjnë për t'ju ndihmuar në Planin e Rrugëtimin, pasi të bien dakord me ju.

Nëse nuk keni të drejtë për mbështetje pasi të mbushni 18 vjeç, ose nuk e dëshironi atë, mund të jeni ende në gjendje të merrni pak ndihmë, por kjo do të varet nga e drejta juaj për të qëndruar në MB.

Getting your voice heard

When you become 'looked after', you should be told about your right to **advocacy**. This is an independent service that can help you explain your problems with the help of a professional who is there to represent your views. Advocacy can help with any issue you have and aims to help you resolve your problem.

Të dëgjuarit e zërit juaj

Kur të filloni të merrni "përkujdesje", duhet t'ju informojnë për të drejtën tuaj për t'u **mbrojtur**. Ky është një shërbim i pavarur që mund t'ju ndihmojë të shpjegoni problemet tuaja me ndihmën e një profesionisti që është aty për të përfaqësuar pikëpamjet tuaja. Avokati mund t'ju ndihmojë me çdo problem që keni dhe ka për synim t'ju ndihmojë në zgjidhjen e problemeve tuaja.



If things don't go well

If you don't agree with the way you are being looked after or something isn't going well, you can complain. Advocacy may help you make your complaint.

Every local authority has a complaints process and if needed your social worker can give you more information about this.

If the local authority doesn't deal with your complaint properly, you may be able to complain to the Local Government Ombudsman.

Nëse gjërat nuk shkojnë mirë

Nëse nuk jeni dakord me mënyrën se si po merrni përkujdesje ose nëse diçka nuk po shkon mirë, mund të ankoheni. Avokati mund t'ju ndihmojë të bëni ankesën tuaj.

Çdo autoritet vendor ka një proces ankesash dhe nëse nevojitet, punonjësi juaj social mund t'ju japë më shumë informacion për këtë.

Nëse autoriteti vendor nuk e trajton siç duhet ankesën tuaj, ju mund të ankoheni te Avokati i Popullit i Pushtetit Lokal.



**Organisations
that can help you:**

Asylum Justice
asylumjustice.org.uk
029 2049 9421



Asylum Justice
asylumjustice.org.uk
029 2049 9421

Welsh Refugee Council
welshrefugeecouncil.org.uk
029 20489 800



Këshilli i Refugjatëve i Uellsit
welshrefugeecouncil.org.uk
029 20489 800

TGP Cymru
trosgynnal.org.uk
029 2039 6974



TGP Cymru
trosgynnal.org.uk
029 2039 6974

Ethnic Youth Support Team (EYST)
eyst.org.uk
01792 466980/1



**Ekipi i Mbështetjes së të Rinjve dhe Minoriteteve
Etnike (EYST)**
eyst.org.uk
01792 466980/1

Cardiff City of Sanctuary
cardiff.cityofsanctuary.org
029 2048 2478



Cardiff City of Sanctuary
cardiff.cityofsanctuary.org
029 2048 2478

Swansea City of Sanctuary
swansea.cityofsanctuary.org
07496 172895



Swansea City of Sanctuary
swansea.cityofsanctuary.org
07496 172895

Children's Commissioner for Wales
www.childcomwales.org.uk
0808 801 1000



Komisioneri i Fëmijëve për Uellsin
www.childcomwales.org.uk
0808 801 1000

Remember that the police in Wales are here to help you. Don't be afraid to contact them. If it is an emergency, call 999. Otherwise, you can call 101 to speak to the police

Mos harroni se policia në Uells është këtu për t'ju ndihmuar. Mos kini frikë të kontaktoni me ta. Nëse ka urgjencë, telefononi në numrin 999. Përndryshe, mund të telefononi në numrin 101 për të folur me policinë.



Find out more about children's rights and the law as it affects children in Wales on the Children's Legal Centre Wales Website

childrenslegalcentre.wales

01792 295399

childrenslegalcentre@swansea.ac.uk





Mësoni më shumë për të drejtat e fëmijëve dhe ligjin pasi ai prek fëmijët në Uells, që mund t'i gjeni në faqen e internetit të Qendrës Ligjore për Fëmijët në Uells.

📍 childrenslegalcentre.wales

☎ 01792 295399

✉ childrenslegalcentre@swansea.ac.uk



Canolfan
Gyfreithiol
y Plant
Cymru

Children's
Legal
Centre
Wales


Swansea University
Prifysgol Abertawe
Hillary Rodham Clinton
School of Law | Ysgol y Gyfraith


Llywodraeth Cymru
Welsh Government